



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal of Kačanik

01Nr. 60/01-24557/23
Kaçanik, 27.09.2023

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **VIII (tetë)** e rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2023 (Legjislatura e shtatë), mbajtur me 27 shtator 2023. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje fillimisht ishin 24 anëtarë, në ndërkohë arritën anëtarët: Florina Lika Vishi, Betim Shala, Fitore Vishi, ndërkaq 7 anëtarë nga LVV e bojkotuan mbledhjen në të gjitha pikat: Agim Mani, Adnan Reka, Kadrije Lika-Troni, Ernesta Krasniqi, Arta Avdiu, Naim Beça, Bashkim Luma.

Nga Ekzekutivit i Komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, Nënkryetari i Komunës- Sabedin Vishi, Drejtorët e drejtorive: Bahri Selimi-DBF, Ramadush Osmani-DSHPE, Qamil Stagova- DUKMM, Suhad Dullovi- DBPZHR, Dardana Tafili-Dauti-DAP, Zahir Doda- DA, Sali Malsiu-DSHMS, Hafize Sallahi-DKRS, ndërkaq nga zyrtarët e komunës në kuadër të detyrave të punës ishin: Bejtulla Dallosi, Ylber Bajra, pati edhe zyrtar tjerë të komunës.

Nga OSBE mbledhjen e monitoroj, Faruk Dërmaku.

Nga strukturat vendore mbledhja monitorohet përmes Teleprezencës nga Vjosa Ahmetaj-zyrtare në MAPL. Mbledhja ka transmetim të drejtpërdrejtë.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli- Kryesues i Kuvendit
Procesmbajtës, Makfire Malsiu.

Kryesuesi i Kuvendit z. Kemal Murseli: Të nderuar pjesëmarrës, së pari iu përshëndes të gjithëve, iu dëshiroj mirëseardhje, konstatoj kuorumin, prezentë janë 24 anëtarë, Florina Lika-Vishi me lajmëroj se është duke ardhur.

Para se me filluar me mbledhjen në shenjë nderimi dhe respekti për policin e rënë në detyrë, Afrim Bunjaku, në mbrojtje të sovranitetit dhe integritetit, kërkoj me u mbajtur një minutë heshtje.

Pasi u mbajt një minutë heshtje, Kryesuesi i Kuvendit konstatoj me vazhduar me punimet e mbledhjes, kushte pune me u mbajt mbledhja ka, e hapi mbledhjen e VIII (tetë) të rregullt të Kuvendit të Komunës për vitin 2023, data 27 shtator, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Propozim Vendimi për Buxhetin e Komunës së Kaçanikut, për vitin fiskal 2024 dhe vlerësimet për vitet 2025-2026;
3. Propozim Vendimi për rialokimin e mjeteve buxhetore, sipas buxhetit të vitit 2023 (hequr);

4. Propozim Vendimi për transferin e mjeteve buxhetore, sipas buxhetit të vitit 2023;
5. Propozim Vendimi për realizimin e një vizite studimore e anëtarëve të KK, në Republikën e Shqipërisë dhe në Republikën e Malit të Zi;
6. Raporti i punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), për gjashtëmujorin e parë të vitit 2023;
7. Propozim Vendim për miratimin e Raportit përfundimtar të Komisionit profesional të komunës, për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga reshjet breshëri të datës 23.07.2023 në territorin e Komunës së Kaçanikut, në fshatin Biçec;
8. Propozim Vendim Paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës, në shfrytëzim afatshkurtër, në ZK Kaçanik;
9. Propozim Vendim për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës;
10. Propozim Vendim për shpallje me interes të përgjithshëm publik të pronës private 00153-24 të Ramiz Shaqiri, për këmbim me pronën komunale 01908-15, në ZK Kaçanik;
11. Propozim Vendim për shpallje me interes të përgjithshëm publik të pronës private 00643-0 të Adnan Vishi, për këmbim me pronën komunale 00644-1, në ZK Kaçanik;
12. Propozim Vendim për shpallje me interes të përgjithshëm publik të pronës private 00544-0 të Mejdi Xhokli, për këmbim me pronën komunale 00545-0, në ZK Koxhaj.

Lidhur me rendin e punës e hapi diskutim:

z. Agim Mani: Për shkak të shkeljeve të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Udhëzimit Administrativ 03/2024 -për procedurat e themelimit e përbërjes dhe kompetencave për themelimin e komiteteve të përhershme dhe Rregullores për punë të KK, grupi i anëtarëve të LVV ka shprehë shqetësime të vazhdueshme për mospërfillje të UA 03/2014 për kohën dhe materialin e mbajtjes se takimeve të KPF siç është me rregullore. Mospërfillja e rregullores se KK për dërgimin e materialit me kohë, para mbajtjes se KK, mos efikasiteti për me siguruar përgjigje me kohë apo fare në pyetje dhe kërkesa të parashtruara me gojë apo me shkrim nga anëtarët e KK, ndërhyrje të padrejtë dhe të njëanshme të kryesuesit në fjalë të anëtarëve të caktuar të opozitës, reagime neglizhence të kryesuesit të KK kur i ofendon në gjuhë jo parlamentare anëtarët e opozitës. Duke marrë të gjitha këto që u thanë me lartë, ne konsiderojmë se kemi të bëjmë me shkelje të parimeve themelore të demokracisë dhe injorim të plotë nga organi me i lartë i komunës. Si rrjedhojë e këtyre veprimeve të vazhdueshme, ne detyrohemi ta bojkotojmë këtë seancë të KK, me shpresë se do t 'reflektoni dhe të bëheni me demokrat dhe më serioz, dhe të respektoni vullnetin e qytetarëve dhe rolin e opozitës, për me ia kthyer seriozitetin kuvendit.

Për arsyet e theksuara, shtatë (7) anëtarë të LVV i bojkotuan punimet e mbledhjen në të gjitha pikët, përpos anëtarit Raif Kasa-LVV i cili qëndroi në mbledhje në të gjitha pikët.

Pas bojkotimit të punimeve të mbledhjes, prezentë në mbledhje mbetën 19 anëtarë, ndërkohë në pikën e dytë (2) arriti edhe anëtarja Fitore Vishi.

Kryesuesi i Kuvendit: Lidhur me rendin e propozuar të punës e hapi diskutimin:

z. Bahri Selimi: E kam një kërkesë lidhur me pikën e tretë (3): Propozim Vendimi për rialokimin e mjeteve buxhetore, sipas buxhetit të vitit 2023, kërkoj që kjo pikë të hiqet nga rendi i punës, se kemi marrë një njoftim nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit- MKRS, për çështjen e Parkingut në oborrin e komunës. Ne paraprakisht e bëmë Propozim Vendimin për rialokim të këtyre mjeteve –rivlerësimin e këtyre mjeteve nga ky projekt në një projekt tjetër, për shkak se dyshohet për gjetje arkeologjike aty, mirëpo në bazë të vlerësimit të ministrisë, aspekti aerologjik ka përfunduar, se nuk ka gjetje dhe lokacioni nuk i plotëson kushtet për mbrojtje të përhershme, kështu që kërkoj të hiqet nga rendi i punës propozim vendimi për rialokim të mjeteve buxhetore, sipas buxhetit të vitit 2023.

Kryesuesi i Kuvendit: Atëherë a jeni për këtë rend pune, pa pikën 3. Njëzëri u aprovua rendi i punës. Prezentë 19. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës,

APROVOJ

Rendin e punës në përbërje prej 11 pikave, pasi pika me nr. 3 hiqet nga rendi i punës.

U kalua në shqyrtimin e pikëve sipas renditjes:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;

Procesverbali i mbledhjes së kaluar të KK u aprovua njëzëri pa vërejtje. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës,

APROVOJ

Procesverbalin e mbledhjes së VII (shtatë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës Kaçanik, të datës 31.07.2023 / Lënda: 01Nr. 60/01-17845/23.

Kryesuesi i Kuvendit: Kalojmë në pozicionin e Pyetjeve dhe Kërkesave:

Pyetje dhe Kërkesa

z. Agim Çaka: Para se me filluar me pyetjet dhe kërkesat, edhe unë pajtohem që mos të kemi probleme me përcjelljen e materialeve të mbledhjeve.

Pyetjet: 1. Ku kemi arritur me Planin Zhvillimor të Komunës dhe me Hartat Zonale, pasi debati publik me qytetarë për këto çështje është shterë, kur pritet me na ardhur në KK këto çështje?

2. Çështja e rrugës një kahe, e trajtuam në seancën e kaluar, kemi pasur shqetësime sidomos në të subjektit opozitë për këtë rrugë dhe për rrugën "Qamil Ilazi". Unë mendoj se ai vendim duhet me u anuluar, sepse nuk është në interes të qytetarëve. Ka vërejtje e kundërshtime të shumta nga qytetarët dhe nga bizneset që zhvillojnë veprimtaritë aty. Pyetja konkrete është: Cila është procedura e anulimit të atij vendimi, organi që anulon (ekzekutivi apo kuvendi)? Me parkingun që është vendosur aty, vendosja e shenjave për pagesë, shihet se ekzekutivi donë me përfunduar këtë çështje, përkundër pengesave të mëdha në atë rrugë, sidomos për qarkullimin e mjeteve, zhvillimin e bizneseve, kalimin e nxënësve të cilët shkojnë në shkollë atypari, se iu krijohet vështirësi me kaluar nëpër makina, kështu që ai vendim duhet me ndërruar dhe me marrë vendim tjetër.

3. Pyetje: Çështja e punimeve që po zhvillohen në ndërtimin e shkallëve të gjimnazi "Skënderbeu", nuk jemi kundër ndërtimit të shkallëve, shkallët kanë qenë në riparim në vitin e kaluar, janë shpenzuar mjete, dhe ato mjete ndikojnë në buxhet, ndërkaq e njëjta punë bëhet sivjet. Pyetja: Pse bash me 1 shtator fillojnë punimet aty? A do të përfundojnë shpejtë ndërtimi i atyre shkallëve, që shkolla me filluar procesin mësimor? A ka punime në shkolla tjera dhe a ka filluar normal procesi mësimor?

Kryesuesi i Kuvendit: Kërkesa të tjera nuk ka, kalojmë në pikën e dytë:

2. Propozim Vendimi për Buxhetin e Komunës së Kaçanikut, për vitin fiskal 2024 dhe vlerësimet për vitet 2025-2026;

Materialin e keni marrë, materiali është trajtuar ashtu siç e përcakton ligji, data e fundit është 30 shtator, por ne po e trajtojmë me këtë datë që me krijuar mundësinë e përpilimit të vendimit dhe dërgimin e tij në ministri. Fjalën e ka drejtori i drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Bahri Selimi:

z. Bahri Selimi: Ashtu siç e potencoj edhe kryesuesi, materialin e keni marrë. Buxheti i planifikuar për vitin 2024 është: 11,958,983.00 €, ndërsa për vitet për vitin 2025 vlerësimet e projektuara janë në masë monetare prej 12,579,771.28€ dhe për vitin 2026 në shumë prej 13,195,938.00€, d.m.th. kemi rritje të vazhdueshme të buxhetit. Sipas burimeve të financimit se nga kanë rrjedhë shumat e buxhetit, e kemi grantin specifik për arsim që është mbi 4.3 milion, grantin përgjithshëm, 5.2 milion, grantin specifik për shëndetësi 1.5 milion. Të HVK janë 924, 200€. Buxheti i vitit 2024 ka ngritje për 12.03%. në masë monetare 1, 284,294.00€, e cila rritje shkon në paga dhe mëditje për shkak të ndryshimit të Ligjit të pagave. Pagat janë kalkuluar me vlerën e koeficientit 110 në vitin 2024, pagat do të jenë me të larta 1,187,572€, ndërkaq sivjet janë me koeficientin 105. Për të ruajtur strukturën e Investimeve kapitale, jemi munduar me bërë kurse të kategoritë tjera buxhetore, Mallra dhe Shërbime t'i ulim për 71,000€, Shpenzimet komunale rriten për 650,000€, Subvencionet dhe transferet 25,529€ për subvencionimin e disa aktivitete kulturore dhe sportive. Investimet Kapitale, 191,448€. Të lista e projekteve kapitale e kemi një ndryshim, të arsimit fillor, projekti për furnizim me mobilje dhe pajisje në shkollë, është riemëruar me kërkesë, ashtu siç e kërkon edhe ministria të subvencionohen projektet, tani është riemëruar me projektin "Ndërrimi i kulmit të shkollës së mesme dhe të ulët "Agim Bajrami" në f. Stagovë, shuma 30,000€.

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

znj. Ardita Rrahmani: Miratimi i buxhetit i një komune, nënkupton dritën e gjelbër të realizimit të projekteve, me interes të gjithë qytetarëve të komunës, kategorive, apo thënë me shkurt, buxheti duhet të jetë gjithëpërfshirës. Besoj se KK si organi me i lartë vendimmarrës, në seancat e rregullta do duhet të ishte vend i adresimit të kërkesave dhe i pranimeve të kërkesave direkt të qytetarëve, përmes neve si përfaqësues të qytetarëve këtu. Këtë vit iu bashkova thirrjes së dëgjimeve publike, me gjasë se kërkesat e qytetarëve që unë përfaqësoj, të gjejnë vend në planifikimet e juaja buxhetore, por nuk po e shoh se ka ndonjë rezultat. Ky buxhet i propozuar nga ju, i cili na është adresuar neve, është i njëjti që ka qenë edhe para dëgjimit publik pa asnjë ndryshim edhe pse pati adresim të kërkesave të shumta në dëgjim publik. Nga 54 kode të ndara buxhetore, prej tyre 14 të reja, pushteti nuk e ka pa të arsyeshme rregullimin e trotuarit dhe ndriçimin publik në rrugën "Malsor Dashi" rruga në drejtim të varrezave të reja të qytetit në drejtim të f. Stagovë, rrugë kjo e cila në të ardhmen e afërt, deshëm apo nuk deshëm, do të bëhet zgjerimi i qytetit në atë pjesë. Gjithashtu në këtë planifikim buxhetor, nuk janë ndarë mjete buxhetore për Shtimin e shtretërve të Çerdhes publike në Kaçanik. Në të gjitha këto kode të bartura dhe të reja, pushteti nuk e ka pa të arsyeshme kërkesën e f. Sllatinë për çështjen e ujit të pijes. Kanë kaluar sa vite, ne flasim ende për çështjen e ujit të pijes. Të gjithë që jemi në këtë sallë, paramendoni si mund të jetoni pa ujë të pijes, nuk mundeni me jetuar dhe çdokush që e ka këtë problem shpërngulet, se nuk mund të jetohet pa ujë të pijes. Nuk e keni pa të arsyeshme kërkesën për Ndërtimin e ri dhe Zgjerimin e Urës të shkollës në f. Runjevë, ura e vjetër është nga viti 1982, urë kjo mezi po qëndron në këmbë, e qarkullimi në të është bukur i madh edhe me mjete të rënda. Rrugën që lidh rrugën "Shefket Fera" dhe "Avdurrarum Shehu" është shumë e qarkullueshme, nuk e keni pa të rëndësisë së veçantë për realizim. "Ruga Avdurrarum Shehu" ka rrjet të ujësjellësit, por nuk ka ujë, nuk është lëshuar ende rrjeti i ujësjellësit. Mundeni me u arsyetuar se kompania e ujësjellësit është përgjegjëse, mos mendoni që qytetarët nuk e kanë kontaktuar kompaninë, por nuk ka pasur ndonjë ndryshim. Shqetësim i gjithë qytetarëve të komunës së Kaçanikut, është çështja e Impiantit të ujërave të zeza, kundërmimi që na vjen uratë nga komuna e Ferizajt, akumulimi i mbetjeve të komunës tjetër, na faturohet neve këtu në Kaçanik. As në vitin vijues nuk ka asgjë për këtë çështje, ndonjë foto zyrtare të ndonjë takimi mes dy komunave, mundet

me na u ofruar. Për derisa ka një pushtet të tillë që ndarjen e buxhetit të komunës nuk e bënë në bazë të kërkesave publike të qytetarëve të drejtuar juve, atëherë LDK nuk do të votoj këtë buxhet.

znj. Fitore Vishi: Mendoj se kemi pasur kohë të mjaftueshme për shqyrtimin e Propozim Vendimit për miratimin e Buxhetit për vitin 2024 dhe vlerësimet për vitet 2025 dhe 2026. Propozim Vendimit për miratimin e Buxhetit për vitin 2024 është në shumë prej 11 milion e nëntëqind e tetëdhjetë e tre euro dhe vlerësimet për vitet 2025 dhe 2026, mendoj se i përmbushin planifikimet për shpenzimin e parasë publike dhe investimet e planifikuara kapitale në komunën tonë. Kjo ndarje buxhetore, sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve për vitin fiskal 2024, është në harmoni të plotë me Qarkoren buxhetore 2024.02 të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transereve. Procesi buxhetor për vitet 2024-2026 ka për qëllim ndërlidhjen e planeve dhe politikave buxhetore me prioritet që ka komuna jonë. Në nivelin sektorial, kjo ndërlidhje është realizuar në proporcion me mundësitë buxhetore dhe prioritetet që sektorët buxhetor kanë për vitet 2024-2026. Prandaj, të nderuar kolegë dhe kolege, në emër të grupit parlamentar të PDK, propozoj që ky propozim vendim të votohet unanimisht edhe nga grupet opozitare në kuvend.

z. Rrustem Zenuni: Se pari me vjen keq që një pjesë e opozitës e lëshoj mbledhjen pa ndonjë arsye, mund të kenë pasur ndonjë arsye për çështje të buxhetit, e jo për arsyet e theksuara, për atë jam i sigurt. Unë kam marrë pjesë në dëgjimet buxhetore, i kam ngritur disa kërkesa, kërkesa kryesore është futur në buxhet: Ndërtimi i trotuarit të rrugës nga “Fusha e Pajtimit” deri të restorant “Natyra”. Kam kërkuar me u futur në buxhet, Rregullimi i terreneve sportive, përgjigje nuk kam marrë. Kam kërkuar me bërë diçka për hapjen e rrugës, Semajë-Gaçkë, as për këtë projekt nuk kam marrë ndonjë përgjigje, arsyet nuk i di.

Kryesuesi i Kuvendit: Arsyet për braktisje të seancës nga një pjesë e subjektit të opozitës, të paktën ato që ishin në raport me mua, se asnjëherë nuk kam tentuar të injoroj apo t’ia ndalë fjalën dikujt. Është e vërtetë se e kam shkelë rregulloren e punës së KK se i kam lejuar me debatuar me shumë sesa e lejon rregullorja. Ky është mendim i secilit dhe ne duhet të respektojmë. Kjo është sa për informim të qytetarëve, sepse arsyet që ata i potencuan, nuk ekzistojnë. Është e vërtetë se ndonjëherë ka pasur mundësi me iu shkuar ndonjë material dikujt me vonesë, për të cilat edhe kemi kërkuar ndjesë, se është çështje teknologjike dhe mundet me pasur pengesa në këtë aspekt. Sido që të jetë, ato janë përmirësuar dhe materiali iu ka dërguar secilit. Nuk janë këto arsye për me u largua prej debatit për një pikë që është tepër e rëndësishme për Kaçanikun dhe për qytetarët e saj. Është e arsyeshme me qenë këtu dhe mos me u pajtuar me atë çka përfshinë projekt buxheti, por nuk është e arsyeshme me u larguar nga debati për buxhetin. Sido që të jetë, është mendim i secilit dhe ne duhet ta respektojmë mendimin e secilit.

z. Betim Shala: Kur e pash se në këtë buxhet e keni paraparë një kod për, Vazhdimin e segmentit të rrugës” Ismajl Raka” deri të “Xhamia e Dëshmorëve”, dhe është paraparë kodi për Ndërtimin e rrugës: Runjevë-Stagovë-Kaçanik i Vjetër- Gërlicë, me duhet me ditur a është paraparë në ndonjë formë tjetër, Zgjerimi i rrugës në Lagjen e Re-Runjevë, sepse nëse ndërtohen këto dy rrugë, nuk keni bërë asgjë, nëse nuk hynë si kod buxhetor, Zgjerimi i rrugës në Lagjen e Re.

z. Agim Çaka: Buxheti është një ndër pikat me të rëndësishme që duhet me debatuar shumë. Kam thënë edhe në mbledhjen e kaluar që buxheti duhet me pasur ndarje të drejtë në proporcion me kërkesat dhe nevojat e qytetarëve kudo që janë ato. Shpërndarja e buxhetit që është projektuar, nuk është me e mira dhe nuk është me e qëlluara. Për mendimin tim, për qytetarët që i përfaqësoj, unë i përfaqësoj të gjithë, por për pjesën nga vijë, mendoj se është i kalueshëm, por nuk do të thotë se nëse vlerësohet me nota, e merr notë maksimale, por është kaluese, që d.m.th. për momentin projektet të cilat janë të parapara, janë në interes të qytetarëve. Prandaj, unë mendoj se kështu duhet të mendojnë të gjithë, kërkesat duhet me u bërë, ekzekutivi duhet

me i paraparë se cilat janë me prioritet. Nëse në një komunitet i kompletoni me të gjitha projektet; ujë, drita, rrugë etj. ndërsa një komunitet mos me pasur as ujin e pijes- që është çështje elementare, atëherë këtu ka probleme ekzekutivi që nuk iu jep prioritet çështjeve elementare.

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi: Po pajtohem me fjalët e Agimit që nuk është shpërndarja e buxhetit në formën me perfektë, por në bazë të kërkesave jo vetëm të debatit, por edhe të kërkesave njëvjeçare të qytetarëve që i ngritin për shqetësimet, jemi munduar me bërë një ndarje të njëtrajtshme ashtu siç kemi ditur, brenda mundësive që kemi pasur. E kam thënë edhe me herët edhe tani po e themi: Nuk e kam menduar që tre vite që është kjo qeverisje dhe nuk e kemi asnjë euro investim nga niveli qendror, për kundër kërkesave e shqetësimeve të cilat i kam ngritur në vazhdimësi. Ky buxhet që është, e kemi shpërndarë. Këtë buxhet nuk mund ta rrisim apo të zvogëlojmë, por në kuadër të buxhetit, mundemi me hequr apo me shtuar një projekt, me kërkesa reale dhe mirëkuptim. Kemi ndryshuar shpesh deri në momentin e fundit, megjithatë ky është një buxhet. Të Kërkesat që u potencuan, Ardita i ka pasur 3 kërkesa edhe në mbledhje të KPF, i kam analizuar këto kërkesa. Kërkesa e parë ka qenë, Ndërtimi i trotuarit dhe ndriçimit publik në rrugën “Malsor Dashi”. Kjo kërkesë është shumë e arsyeshme, atë ditë nuk pa i pasur të dhënat zyrtare, nuk munda me fol. Aty i kemi 3 padi, ku jemi në kontest gjyqësor, dy emra mundem me i dhënë, tjetra nuk iu kujtua zyrtarit ligjor se një nga familja Dushkaja, tjetra nga vajza e Mynyr Tirolli, për tjetrën nuk i kam të dhënat, andaj mbi bazën e kësaj e kemi të pamundur me menduar njëherë këtë projekt. 2. Rritja e shtretërve të çerdhja e fëmijëve, në konsultim me drejtorin e DA, ata punëtorë janë të ngarkuar me numrin e fëmijëve që janë në çerdhe. Ne kemi premtime që në vitin vijues do të ndërtohen dy (2) Çerdhe, njëra në f. Malësi-Rekë dhe tjetra në Kaçanik të Vjetër. Është kërkuar prona dhe ne e kemi dedikuar pronën, ku automatikisht shkarkohet pjesa e qytetit, se pjesa dërmuese e fëmijëve janë nga fshatrat. Në momentin kur bëhen këto çerdhe, ndoshta do të ketë edhe vende të lira në çerdhe të fëmijëve. 3. Çështja e ndarjes se një buxheti për gratë asambleiste, ne e kemi marrë miratimin nga kryesuesi i KK se do të keni një buxhet në kuadër të buxhetit të KK. Të pyetja e Betimit, për zgjerimin e rrugës në Lagjen e re në Kaçanik, ndoshta është e mirë me futur si kod, por unë kam menduar, kur të bëhet rruga në pjesën tjetër, ajo rrugë shkarkohet nga qarkullimi. Çështjen e rrugës Runjevë-Stagovë-Kaçanik i Vjetër- Gërlicë e kemi si kod, ne nuk do të bëjmë asnjëherë atë rrugë të kalueshme deri në Gërlicë, pa mbështetje të nivelit qendror, se koston e saj nuk mundem me mbuluar. Në momentin që mbetet kjo pjesa këndeje, ne do ta realizojmë gjithsesi, vetëm a do të kemi fatin me kaluar në nivel qendror me kërkesën të cilën e bëjmë tani në shtator, kjo kërkesë është shumë e arsyeshme, kjo nuk ka diskutim.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë pikë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me 15 votë Për, Kundër 5 (4 anëtarët nga LDK dhe Raif Kasa nga LVV). Abstenim nuk ka. Prezentë 20. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i komunës mori këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Buxhetit të Komunës së Kaçanikut, për vitin fiskal 2024 dhe vlerësimet për vitet 2025-2026/ Lënda: 01Nr. 400/03-24314/23.

Pika me nr. 3. Propozim Vendimi për rialokimin e mjeteve buxhetore, sipas buxhetit të vitit 2023, është hequr nga rendi i punës, me kërkesën e drejtorit të DBF, atëherë Kryesuesi i Kuvendit konstaton me kaluar në pikën e katërt (4):

4. Propozim Vendimi për transferin e mjeteve buxhetore, sipas buxhetit të vitit 2023;

Materialin e keni marrë, drejtori i DBF është këtu për sqarime të nevojshme. E hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë e shtroj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjta u

aprovua me 15 votë Për, Kundër 4 anëtarët nga LDK. Abstenoj Raif Kasa-LVV. Prezentë 20. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për transferin e mjeteve buxhetore, sipas buxhetit të vitit 2023/ Lënda: 01Nr. 400/01-24273/23.

5. Propozim Vendimi për realizimin e një vizite studimore e anëtarëve të KK, në Republikën e Shqipërisë dhe në Republikën e Malit të Zi;

Kryesuesi i Kuvendit: Sa i përket kësaj pike, në rrjetet sociale një kolegë i ynë paska dhënë lajmin se është vendosur për vizitën studimore. Kuvendi vendos sot për vizitën studimore. Sa janë të rëndësishme, kisha pas dëshirë me tepër me i dëgjuar nga ata që kanë qenë, për me treguar se a ka qenë çdo gjë në rregull, sesa nga ata që nuk kanë qenë. Ju informoj se të gjitha kuvendet komunale realizojnë vizita të tilla, bile edhe me shpesh sesa ne dhe atë, jashtë procedurave ligjore, si komuna e Podujevës, kryetari se bashku me zyrtarët komunal nuk i kanë përfillë procedurat e prokurimit. Dëshmi janë raportet e auditorit, ku auditori ka gjetur shkelje në realizimin e mjeteve, se janë bërë pa procedua që e përcakton ligji i prokurimit publik. Për me jep dëshmi, duhet me qenë këtu, por pasi nuk janë, po ua themi tani: Ne sa herë kemi shkuar me procedura të prokurimit, ndërkaq çështja se a shkojmë apo jo në vizitë studimore, vendosë KK, ndërkaq unë ua kam ofruar propozim vendimin. Dy apo tre kuvende komunale kanë shkuar në Turqi, për ne shpenzimet janë të mëdha. Ne vendosim bashkërisht për këtë çështje, për mua nuk prishë punë se kjo është një obligim shtesë, unë realizoj vizita zyrtare edhe pa miratimin e atyre që flasin për këtë çështje. Vizita studimore është e mirë ardhur, ata që kanë qenë në këto vizita, e dinë se këto vizita kanë ndikuar në krijimin e raporteve që i ndjekin edhe sot me komuna të ndryshme që i kemi vizituar. E hapi diskutimin:

z. Rustem Zenuni: Ne jemi për realizimin e kësaj vizite, për një arsye që unë e kam, unë nuk kam qenë asnjëherë në shtëpinë muze në bashkinë e Vlorës. Është shumë arsyeshme për komunën tonë, dhe e kam pas shfrytëzuar momentin kur kryesuesja e Këshillit Bashkiak na u ka drejtuar neve për realizimin e vizitave. Neve na duhen këto vizita, e në veçanti në Shqipëri dhe vende tjera. Ne e përkrahim, ndërkaq është mirë që vitin tjetër me realizuar ndonjë vizitë në vende tjera.

Kryesuesi i Kuvendit: Propozim Vendimi ka rrjedhë edhe nga Plani i punës së KK për vitin 2023, dhe jemi në harmoni me planin.

z. Agim Çaka: Vizitat të cilat i realizojmë si KK, janë të mirëseardhura, ndërsa pjesa se qysh i realizojmë, ajo është diçka tjetër. Unë jam i mendimit për vizitat që i realizojmë, me përfituar diçka nga këto vizita, si njohuri të reja, kulturë, njohim strukturat komunale. Ne vizitat që i realizojmë e shohim se si po funksionon qeverisja lokale, cilat janë përparësitë, cili është modeli, qysh është qyteti i asaj komune. Vizita me u realizuar si vizitë pune me zyrtarët e asaj komune, dhe me sjellë se paku një përvojë të mirë të asaj komune dhe Kuvendeve komunale, e mos me lënë hapësirë me u interpretuar keq. Edhe unë jam për realizimin e vizitës, por jo me shkuar si turist vetëm me bërë shpenzime. Ne kemi zyrtarë këtu, por edhe nëpër ministri që me letra figurojnë, por që nuk punojnë sa duhet, por kjo është relative. Jam për realizimin e kësaj vizite studimore, që të përfitojmë njohuri të reja nga kjo vizitë.

Kryesuesi i Kuvendit: Qëllimi i vizitës është shkëmbimi i përvojave dhe unë në këto debate, pres se çka mund të përfitojmë nga vizitat e realizuara se e kemi përvojën nga viti i kaluar, dhe çka ne duhet përmirësojmë në kuadër të këtyre vizitave. Edhe në legjislaturën e kaluar, këto vizita janë bërë në bashkëpunim me shefat e grupeve të përfaqësuara në KK, se bashku e kemi bërë agjendën.

znj. Ardita Rrahmani: LDK është e pajtimit për realizimin e këtyre vizitave studimore.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë pikë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Prezentë 20. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për realizimin e një vizite studimore e anëtarëve të KK, në Republikën e Shqipërisë dhe në Republikën e Malit të Zi/ Lënda: 01Nr. 60/01-24306/23.

6. Raporti i punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB), për gjashtëmuorin e parë të vitit 2023;

Kryesuesi i Kuvendit: Raportin e KKSBB e keni marrë, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Rrustem Zenuni: Unë e kam lexuar raportin, ndërkaq shqetësim paraqet prerja e pyjeve në malet e Sharrit, e cila gjendje na ka shëmtuar natyrën. Kërkoj të shqyrtohen mundësitë me u angazhuar me tepër në këtë drejtim, për eliminimin e kësaj dukurie negative.

Kryesuesi i Kuvendit: Raporti kalon si informatë, kështu që konstatohet se Kuvendi i Komunës,

Njoftohet

Me aktivitetin e KKSBB, përmes Raportit të punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB), për gjashtëmuorin e parë të vitit 2023/ Lënda: 01Nr. 60/01-24256/23.

7. Propozim Vendim për miratimin e Raportit përfundimtar të Komisionit profesional të komunës, për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga reshjet e breshrit të datës 23.07.2023 në territorin e Komunës së Kaçanikut, në fshatin Biçec;

Kryesuesi i Kuvendit: Kjo çështje ka kaluar edhe procedurën e KPF, ku drejtori ka sqaruar këtë Propozim Vendim. E hapi diskutimin:

z. Selajdin Troni: Unë e pash që komisioni ka vlerësuar dëmin në f. Biçec, ndërkaq me intereson të di, a ka pasur edhe kërkesa tjera, se ka pasur prishje të kulmeve të stallave etj. nga erërat e ndryshme ?

z. Rrustem Zenuni: Në fillit të vitit, në muajin janar-shkurt ka pasur vërshime, se edhe mua personalisht, por edhe qytetarëve tjerë u janë dëmtuar serat. Pata kontaktuar me drejtorin për me dalë me bërë diçka në këtë drejtim, por si duket nuk i ka ardhur radha. Besoj se ato dëme të shkaktuara është dashur të përfshihen në këtë propozim vendim.

z. Agim Çaka: Është e vërtetë se çështja është për një lëndë dhe diskutimi duhet me u përqendruar në këtë lëndë, por çështja lindë se dëmi nuk iu ka shkaktuar vetëm një personi, pasi breshër ka pasur në krejt atë pjesë. A ka pasur edhe kërkesa tjera që kanë kërkuar ndihmë dhe a iu ka ofruar ndihma. Po ndërlidhem në këtë pikë edhe me një çështje të ngjashme që ka ndodhur para disa viteve Sankosit, për vërshimet nga lumi lepenc. Sa kam njohuri ai ka bërë kërkesë në komunë për ndihmë. A i është ofruar ndihmë, se dëmi ka qenë 100 herë me i madh sesa ky? Kapacitetet dhe mundësitë e komunës e di se nuk kanë qenë për me ndihmuar dhe me ia kompensuar atë dëme. Mua po me intereson të ai rast, a ka pasur interesim nga komuna dhe a iu ka ndihmuar kompensimi i dëmit?

z. Suhad Dullovi: Sa i përket kërkesave të fermerëve, kërkesat ka qenë në drejtorinë e Bujqësisë, komisioni ka dalë në vendngjarje dhe i ka vlerësuar dëmet e shkaktuara. Komisioni ka vlerësuar se personit në fjalë iu kanë bërë dëme. Dëmet kanë qenë të serat me tepër nga erërat etj., ne nuk kemi pasur kapacitet si drejtori t'i mbulojmë dëmet e serave të shkaktuara

nga fatkeqësitë natyrore. Dëmet në bujqësi paguhen 30%, një najlon i një sere kushton 100 €, që i bien që ministria ia mbulon 30€ shpenzimin e najlonit. Kërkesat tjera bien poshtë, sepse ministria i subvencionon vetëm serat mbi 5 ari, serat tjera kanë qenë të vogla dhe nuk kemi gjetur mbështetje. Sa i përket dëmit breshëri, komisioni ka dalë në terren, e ka vlerësuar dëmin dhe vetëm kjo që është propozuar i plotëson kushtet për subvencionim. Kërkesa është dërguar në ministri, tani kjo është kompetencë e Agjencisë për menaxhimin e emergjencave. Komisioni është prej 5 anëtarëve, dhe çështja është proceduar në KK, pas miratimit, vendimi dërgohet në qeveri për vlerësimin dhe kompensimin e dëmit.

z. Selajdin Troni: A keni numrin e ankesave që kanë bërë për kompensimin e shpenzimit të najlonit të serave. Nëse janë dëmtuar 20-30 sera, dëmi nuk është shumë i madh, që mos me pasur mundësi me i mbuluar komuna me mjete vetanake.

z. Suhad Dullovi: Kërkesat të cilat kanë ardhur për sera, serat nuk kanë garanci për vërshimet natyrore, se janë sera të vogla, kështu vazhdojmë me mbështetjen e fermerëve për dëmet tjera për të cilat fermerët bëjnë kërkesa.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë pikë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Prezentë 20. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për miratimin e Raportit përfundimtar të Komisionit profesional të komunës, për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga reshjet e breshrit të datës 23.07.2023 në territorin e Komunës së Kaçanikut, në fshatin Biçec/ Lënda: 01Nr. 320/01-24456/23.

8. Propozim Vendim Paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës, në shfrytëzim afatshkurtër, në ZK Kaçanik;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

znj. Arlinda Rakoci- Raka: Kërkoj të di se ku gjendet lokacioni i këtyre tokave?

z. Qamil Stagova: Kjo çështje ka qenë edhe në mbledhjen e kaluar, mirëpo është dashur të ndahet dhënia afatshkurtër e pronave komunale, me vendim të veçantë. Prona gjendet të vendi i ashtuquajtur "Seperacija", të Tregu i kafshëve.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë pikë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me 15 votë Për, Kundër ishin 4 anëtarët nga LDK, Abstenoj Raif Kasa- LVV. Prezentë 20. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM PARAPRAK

Për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës, në shfrytëzim afatshkurtër, në ZK Kaçanik/ Lënda: 01Nr. 104/02-24407/23.

9. Propozim Vendim për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës;

Kryesuesi i Kuvendit: Kur kemi këso raste, duhet të formohet komision i veçantë për vlerësimin e ofertave. Përbërja duhet të jetë, 2 anëtarë nga Ekzekutivi, 2 anëtarë nga KK dhe 1 anëtar nga Shoqëria civile. Nëse nuk ka kush diçka, shkojmë me propozime konkrete, duke filluar nga subjekti me i madh politik-PDK.

z. Rrustem Zenuni: Nga Subjekti politik i PDK e propozojmë për anëtar të komisionit të jetë, Selajdin Troni.

Kryesuesi i Kuvendit: Meqë anëtarët e LVV nuk janë këtu, atëherë kërkoj nga Raif Kasa nëse është i interesuar të merr fjalën në emër të LVV.

z. Raif Kasa: Nuk jam i interesuar me marrë fjalën.

Kryesuesi i Kuvendit: Atëherë kalojmë në subjektin tjetër politik-LDK, të jep një propozim për anëtar të komisionit.

znj. Ardita Rrahmani: Subjekti politik i LDK nuk ka propozim për anëtar të këtij komisioni.

Kryesuesi i Kuvendit: Atëherë kalojmë në subjektin tjetër politik AAK, të jep një propozim për anëtar të komisionit.

z. Ekrem Livoreka: Subjekti politik i AAK nuk ka propozim për anëtar të këtij komisioni.

Kryesuesi i Kuvendit: Atëherë kalojmë në subjektin tjetër politik NISMA, të jep një propozim për anëtar të komisionit.

z. Agim Çaka: Kur të propozohet një çështje, kërkoj të sqarohen të dhënat me në detaje, si fjala "Seperacija", pastaj me ditur sa është afati i shkurtër kohor, kush ka me investuar aty, çka ka me u investuar. Mos na bini në pozita të këqija, që ne mos me i votuar këto çështje. Unë kam thënë se kam me i votuar këto çështje dhe e votova vendimin paraprak. Unë jam me u angazhuar për me ecur çështjet përpara, por jam me e ndal një traditë të keqe, që t'i rregullojmë punët mbarë dhe mirë, ndërkaq shtoj se nuk kam propozim për anëtar të këtij komisioni nga subjekti politik NISMA.

Kryesuesi i Kuvendit: Komisioni për atë çështje formohet, për me pa çfarë ofertash ka, kush çka po kërkon. Komisioni e sjellë çështjen në KK. Nëse thoni se a po përmbushen ato që po vijnë në KK, aty kemi të drejtë, se në shumë raste nuk janë përmbushur, por derisa çështja të vjen deri aty, me procedura jemi krejt në rregull. Po kërkohej gjithëpërfshirës në komision, për me pa edhe ai që është në pozitë dhe ai që është në opozitë, për kërkesat që paraqitën, veprimtaritë e tyre. Komisioni i analizon me në detaje, dhe çështja përsëri vjen në KK për miratim. Nuk e di qysh po doni me ditur për kërkesat, kur nuk doni me qenë pjesë e komisionit.

z. Selajdin Troni: A ka ofertues për pronën e përcaktuar?

Kryetari i Komunës: Ofertat vijnë pasi të bëhet thirrja publike. Afati i dhënies në shfrytëzim është 15 vjet.

Agim Çaka: Unë mendoj se pa e kërkuar dikush atë pjesë të pronës në shfrytëzim, nuk besoj se kishte dalë në KK. Çështja është, me ditur saktë për cilën parcelë është fjala dhe çka ka qenë ajo deri tani, cilat janë planet e komunës, për atë thashë me diskutuar, se çështja e dhënies në shfrytëzim të pronave komunale, formimi i komisionit, janë procedura të rregullta. Për secilën pronë duhet me na ofruar fakte për vendin e pronës, përkufizimin, e ka shfrytëzuar apo jo deri tani komuna për ndonjë veprimtari të caktuar atë pronë, çështja se për çka kemi me shfrytëzuar tani e tutje, se ne në mbledhjen e kaluar morën një vendim paraprak për me dhënë në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të disa pronave komunale.

Kryesuesi i Kuvendit: Ne e kemi marrë vendimin në mbledhjen e kaluar, por na e ka kthyer MAPL, pasi ka theksuar se për afatgjatë ka thënë me qenë i veçantë vendimi, për afatshkurtër i veçantë, kjo është arsyeja që e kemi sjellë këtë propozim vendim në KK.

z. Qamil Stagova: Pajtohem me Agimin. Ne me qëllim nuk e kemi kufizuar sipërfaqen e pronës. Prona është me sipërfaqe me të madhe, varësisht prej kërkesave mendojmë se deri ku me përkufizuar. Është fjalë për një pronë afër lumit. e cila në shënimet kadastrale është tokë e degraduar. E kemi pasur një propozim për sa sipërfaqe, por me qëllim nuk e kemi lënë të hapur,

varësisht prej kërkesave. Kërkesa kemi, nuk është nevoja me i potencuar. Komisioni e përgatit Ankandin dhe konkurrojnë firmat. Komisioni i vlerëson ofertat dhe rezultatit e vlerësimit e procedon në KK.

Kryesuesi i Kuvendit: Meqë subjektet tjera politike nuk duan të jenë pjesë e komisionit, atëherë kryesuesi kërkoj nga subjekti politik i PDK të jep edhe një propozim për anëtar të komisionit.

z. Rrustem Zenuni: Nga PDK e propozojmë Florina Lika Vishi për anëtare të këtij komisioni.

Kryesuesi i Kuvendit: Kërkoj nga Ekzekutivi të jep emrat për anëtarë të komisionit.

Nga Ekzekutivi i Komunës, z. Qamil Stagova propozoj për anëtarë të komisionit dy anëtarë: Vedat Dema, Rakip Vishi, ndërkaq nga OJQ, Elmihane Krasniqi-Malsiu.

Kryesuesi i Kuvendit: Atëherë propozimet që dolën i shtroj në votim për aprovim dhe të njëjtat u aprovuan me 15 votë Për, Kundër ishin 3 anëtarë nga LDK (Ardita Rrahmani, Arlinda Rakoci-Raka, Betim Shala), Abstenuan 2 anëtarë (Besnik Salihu dhe Raif Kasa). Prezentë 20. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës, në përbërje:

- | | |
|------------------------------|---------------------------|
| 1. Vedat Dema, | anëtar (Ekzekutivi) |
| 2. Rakip Vishi, | anëtar (Ekzekutivi) |
| 3. Selajdin Troni, | anëtar (Kuvendi -PDK) |
| 4. Florina Lika-Vishi, | anëtar (Kuvendi- PDK) |
| 5. Elmihane Krasniqi-Malsiu, | anëtar (Shoqëria Civile)/ |
- Lënda: 01Nr. 104/02-24403/23.

10. Propozim Vendim për shpallje me interes të përgjithshëm publik të pronës private 00153-24 të Ramiz Shaqiri, për këmbim me pronën komunale 01908-15, në ZK Kaçanik;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Agim Çaka: Është një gabim teknik, se nuk është Razim Shaqiri, por Ramiz Shaqiri. Nëse prona është me interes të përgjithshëm, duhet me këmbyer pronën. Kërkoj të di arsyet e këmbimit, se çka donë komuna me bërë në atë pronë që po e këmben?

z. Qamil Stagova: Prona është të rruga “ Emsale Frangu” në afërsi të shkollës “Emin Duraku”, aty do të bëhet asfaltimi i rrugës dhe zgjerimi i saj, e cila rrugë në vende të caktuara tani për tani është shumë e ngushtë. Aty ka prona private jo vetëm e Ramizit por edhe prona tjera që preken, në anën tjetër të rruga që shfrytëzohet tani. Prona në emër të Ramizit një pjesë i kalon komunës, ndërsa pjesa tjetër ku është e komunës i kalon Ramizit.

Kryesuesi i Kuvendit: Në Propozim Vendim është mirë, ndërkaq në ftesë është bërë gabimi teknik, kërkoj falje për këtë gabim.

z. Selajdin Troni: Unë e njoh atë terren dhe është shumë e nevojshme me u bërë zgjerimi i asaj rruge edhe për nxënës edhe për kalimtarë tjerë.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë pikë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Prezentë 20. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për shpallje me interes të përgjithshëm publik të pronës private 00153-24 të Ramiz Shaqiri, për këmbim me pronën komunale 01908-15, në ZK Kaçanik/Lënda: 01Nr. 104/02-24408/23.

11. Propozim Vendim për shpallje me interes të përgjithshëm publik të pronës private 00643-0 të Adnan Vishi, për këmbim me pronën komunale 00644-1, në ZK Kaçanik;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Qamil Stagova: Familja Vishi ka pasur një padi për një pjesë të pronës e cila është e rrethuar me muri, pretendon se të kaluarën e kanë blerë atë pronë, mirëpo shënimet tregojnë se prona është e komunës. Prona në një pjesë është e tyre, në një pjesë e komunës, një pjesë tjetër që është në emër të atyre e shfrytëzon komuna. Ne kemi arritur marrëveshje që një pjesë ku e kanë shtëpinë dhe një pjesë para shtëpisë i kalon kësaj familje rreth 29m², kurse 26m² që është pronë e kësaj familje i kalon komunës. Pjesa që e merr komuna është nga rruga dhe është ma me vlerë sesa pjesa që e merr familja. Është bërë marrëveshje dhe pala e ka tërheqë padinë prej Gjykatës.

znj. Ardita Rrahmani: A ka ndonjë plan komuna për atë pjesë për të ardhmen ?

z. Qamil Stagova: Për momentin jo.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë pikë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Prezentë 20. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për shpallje me interes të përgjithshëm publik të pronës private 00643-0 të Adnan Vishi, për këmbim me pronën komunale 00644-1, në ZK Kaçanik/ Lënda: 01Nr. 60/01-24386/23.

12. Propozim Vendim për shpallje me interes të përgjithshëm publik të pronës private 00544-0 të Mejdi Xhokli, për këmbim me pronën komunale 00545-0, në ZK Koxhaj;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

znj. Arlida Rakoci-Raka: Parashtroj pyetje se ku gjenden këto prona?

Kryesuesi i Kuvendit: Prona është të rruga e Koxhajve, të shtëpia e Mejdiut, shihet edhe muri aty. Kjo çështje është dashur me herët me na ardhur në KK, por çështja është se ai e ka pasur pronën në hipotekë dhe nuk ka mundur me bërë këmbimin. Rruga shihet se është me e ngushtë të pjesa e shtëpisë së Mejdiut dhe ka nevojë të zgjerohet. Diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë pikë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Prezentë 20. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për shpallje me interes të përgjithshëm publik të pronës private 00544-0 të Mejdi Xhokli, për këmbim me pronën komunale 00545-0, në ZK Koxhaj/ Lënda: 01Nr. 60/01-24387/23.

Mbledhja i përfundoj punimet në ora 12:20. Deri në fund të mbledhjes ishin 20 anëtarë, pasi 7 anëtarë nga LVV i bojkotuan të gjitha pikat e mbledhjes.

Procesmbajtëse

Makfire Malsiu

Makfire Malsiu



Kryesuesi i Kuvendit

Kemal Murseli